

# UDHËZUES - VIDEO PRODUKSION



*Krijimi i videove për profesione*

## SI DUHET TË DUKET NJË VIDEO?

- Të jetë format MPEG, mp4 ose format i ngjashëm
- Të jetë 3 deri në 5 minuta
- Të ketë një vijë melodike në sfond që i plotëson standardet e të drejtave të autorit sipas ligjit mbi të drejtat autoriale
- Nëse në video ka foto të marra nga interneti duhet t'i plotësojnë standardet e të drejtave të autorit sipas ligjit mbi të drejtat autoriale:
  - <https://www.bensound.com/> (në fund të videos, duhet të njihen të drejtat e autorit duke shkruar vendin/platformën ku është marrë muzika)
- Të përshkruhet profesioni me saktësi:
  - Shkollimi i nevojshëm
  - Aktivitetet ditore
  - Veglat e punës
  - Ambienti dhe kushtet e punës
  - Trajnimet / certifikimet e nevojshme
  - Aktualiteti në tregun e punës
- Të shpjegohen kualifikimet arsimore dhe trajnimet e kërkuara për profesionin
- Të tregohet ambienti i punës ku ushtrohet profesioni
- Të përmenden çështje shëndetësore dhe të sigurisë (nëse ka) lidhur me profesionin.

### MËNYRAT E REALIZIMIT TË VIDEOS:

- Përzgjedhja e profesionit
- Përzgjedhja e profesionistit/profesionistës që dëshironi të intervistoni
- Përgatitja e pyetjeve për intervistë
- Caktimi i datës, kohës dhe vendit për mbajtjen e intervistës (preferohet vendi i punës i/e të intervistuarit/intervistuarës)

- Përgatitja e storyboard-it
- Sigurimi i pajisjeve të nevojshme për xhirim
- Editimi i materialit të realizuar në xhirime <https://www.youtube.com/watch?v=t1b2-y-uoFQ>
- Aplikimi i komenteve nga KCDF.

### SHEMBUJ TË VIDOVE TË PROFESIONEVE:

- <https://youtu.be/bAjbme00Ccc>
- [https://youtu.be/\\_vcgRJ9UN\\_c](https://youtu.be/_vcgRJ9UN_c)
- <https://youtu.be/GrHYGTm-r9s>

### NJË VIDEO E MIRË DUHET TË KETË:

- Cilësi të pamjeve
- Cilësi të zërit (muzika dhe zëri i incizuar)
- Saktësi të informacioneve mbi profesionin e zgjedhur
- Materiali i përgatitur nuk duhet të përmbajë gjuhë dhe pamje të urrejtjes, respektivisht të diskriminimit, si dhe elemente tjera të papërshtatshme.

### KU DUHET TA DORËZONI VIDEON?

- Pas aprovimit të videos finale nga KCDF, ajo duhet të dërgohet në e-mail adresën: [flandra.sadiku@koscdf.org](mailto:flandra.sadiku@koscdf.org)
- Nëse skedari është shumë i madh për t'u dërguar në e-mail, mund të përdorni platformën [www.wetransfer.com](http://www.wetransfer.com)